

VENDIM
Nr. 476, datë 16.7.2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në listën e shkronjës "C", "Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", shtohet individi i renditur në listën "a", "Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida.

2. Nga lista e shkronjës "C", "Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", çregjistrohen individët e renditur në shkronjën "b" të listës, "Lista e individëve të çregjistruar nga lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, si persona të çregjistruar nga anëtarë bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

3. Në listën e shkronjës "D", "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida", shtohet grupimi i renditur në shkronjën "c" të listës, "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për kompanitë ose grupet që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TE SHPALLUR

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT ("LISTA E OKB-së")

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Lista e shtuar në **"Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida"**;

1. ABUBAKAR; MOHAMMED; SHEKAU.

b) Lista e individëve të çregjistruar në **"Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida"**;

1. ABDERRAHMANE; KIFANE;
2. AMRAN; MANSOR;
3. SON; HADI; BIN MUHADIJIR;
4. YOUSSEF; BEN ABDUL BAKI; BEN YOUSSEF; ABDAOUI
5. WALI; UR REHMAN.

D. LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

c) Lista e shtuar në **"Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida"**;

1. ANSARUL MUSLIMINA FI BILADIS SUDAN

Shënim: Gjeneralitet e tjera për personat dhe kompanitë emrat e të cilave janë radhitur me sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

